



L'albero della salute®

Struttura referente per Mediacionin kulturor ne shëndetësi – Krahina e Toskanës



Mum Health – Shëndeti i Nënës

Një ndërhyrje krahinore për promovimin e shëndetit global të grave

SKEDË E PËRMBLEDHUR PREZANTIMI

*Kur gratë janë mire me shëndet e gjithë bota ndihet më mirë
[A. Sen , 2001]*

Promovimi i shëndetit të gruas.

Promovimi i shëndetit të gruas është prej kohësh objekt i vëmendjes dhe i programeve ndërkombëtare e kombëtare. Organizata Botërore e Shëndetit, duke filluar që nga vitet “80”, ka promovuar angazhimin për reduktimin e mortalitetit femëror dhe të ndërlikimeve të shtatzanërisë dhe të lindjeve, duke lehtësuar hyrjen e grave në shërbimet shëndetësore kudo në botë. Ky angazhim i përket të drejtës për jetën, për sigurinë, respektimit të përkatësive të ndryshme dhe të drejtës së jo-diskriminimit.

Mum Health: një ndërhyrje e krahinës Toskana.

Ndërhyrja Mum Health e krahinës së Toskanës nisët nga prania gjithnjë e më e konsiderueshme e grave imigrante në vendin tonë dhe në Toskanë dhe nga nevoja e vigjilimit mbi shëndetin femëror, në mënyrë speciale atij riprodhues. Sipas kërkimeve kombëtare (Raporti Istisan 1999 e 2006) pengesat e shumta shoqërore dhe gjuhësore vështirësojnë hyrjen dhe përfitimin e plotë të shërbimeve shoqërore-shëndetësore nga migrantët dhe krijojnë rrezikun e një asistence më të paktë në shtatzanëri, të një përdorimi jo korrekt të mjeteve kundërpllenuese dhe të rritjes së rasteve të ndërprerjes vullnetarisht të shtatzanisë.

Rruga e ndërmarrë parashikon aksione formimi drejtuar operatorëve shoqërore-shëndetësorë të të gjitha ndërmarrjeve të krahinës së Toskanës, që zhvillohen në një periudhë shumë mujore. Paralelisht ka filluar edhe prodhimi i materialeve multimediale, në gjuhë të ndryshme, mbi shëndetin riprodhues për të favorizuar njohjen dhe frekuentimin e konsultorit. Është parashikuar, për më tepër, në Firenze një cikël takimesh tematike “Të enjtet e Pemës së shëndetit” për të përhapur e për të mbështetur synimet e ndërhyrjes.

Përgjegjësia për shëndetin vetjak.

Mum Health kërkon të nxisë ndër gratë migrante, që gjenden në të gjithë territorin toskan, përgjegjësinë për shëndetin vetjak, i kuptuar ky edhe si shëndet riprodhues, me përfitim pra për shëndetin e fëmijevë dhe të të riturve, në bazë të rolit të kujdesit që gruaja ushtron në familje. Ndërhyrja favorizon rritjen e kompetencave të grave mbi shëndetin dhe hyrjen në kontakt me shërbimet sipas mënyrave të pjesëmarrjes. Eksperienca e vendeve me një taksë të madhe imigrimi si Anglia i rrit vlerën pjesëmarrjes së grupeve të migrantëve në realizimin e ndërhyrjeve, sepse

promovon rolin e “ofertës aktive” të shërbimeve shëndetësore, të përqëndruara pra mbi nevojat e personave dhe në gjendje që t’u vijnë atyre në ndihmë

Mum Health kujdeset për shëndetin ‘global’, me fjalë të tjera për një të mirë të padukshme e të pandarë, që ve në lidhje shëndetin e individit me atë të ambientit dhe të rrjetit shoqëror. Synon pra të favorizojë situata të njohjes dhe shkembimit midis njerëvze me prejardhje, gjini, përkatësi kulturore e gjuhësore të ndryshme por që banojnë në të njejtin territor

Ndërhyrja Mum Health e Krahinës Toskana realizohet në bashkëpunim me Ndërmarrjet Shëndetësore të Toskanës dhe koordinohet nga “Pema e Shëndetësisë” si Strukturë referimi për ndërmjetësimin kulturor në shëndetësi, në kuadrin e programit të ndërhyrjeve rikualifikuese të shërbimeve informuese dhe të edukimit më përgjegjësine prindërore të nënës e babait dhe me seksualitetin e vetëdijshëm.

[D.G.R. n°259, dispensa e bashkangjitur C, 21 prill 2006]

Objektivat dhe strategjitë

Qëllimi final i ndërhyrjes së quajtur *Mum Health* është nxitja dhe përmirësimi i shëndetit, në kuptimin e “shëndetit global”, të grave të huaja të pranishme në territorin toscan, edhe per rezultatet që kjo gjë i sjell shëndetit të tërësisë së komuniteteve të migrantëve dhe në mënyrë të veçantë të fëmijëve, falë rolit qëndror që gruaja luan brenda tyre si “dhuruese kujdesi”

Objektivat e projektit janë:

- 1 Përmirësimi i njohuritë të grave migrante mbi shërbimet shoqërore si në aspektin e të drejtës së përfitimit ashtu edhe në atë të ofertës
- 2 Përmirësimi i njohurive të grave e meshkujve migrantë mbi kundërpllenimin me qëllim reduktimin e përdorimit të IVG.së
- 3 Përmirësimi i njohurive të grave migrantë lidhur me nënkqyrjen e tumoreve femërore
- 4 Favorizimi i procesit të lindjes tek gratë e huaja
- 5 Fuqizimi i përdorimit të shërbimeve shoqërore-shëndetësore tek migrantët në periudhën e pas lindjes

Strategjitë e përdorura janë:

- promovimi i *shëndetit njohës* të grave migrante
- bashkëpunimi me komunitetet e huaja në identifikimin dhe realizimin e aktiviteteve
- rritja e nivelit të aftësisë së utencës migrante në mënyrë të veçantë të grave;
- formimi i operatoreve;
- përhapja e informacionit;
- puna në rrjet;
- organizimi i shërbimeve duke marrë parasysh vështirësitë e grave dhe burrave migrantë për frekuentimin e vetë shërbimeve;
- edukimi me njohjen e shërbimeve shoqërore-shëndetësore.

Aktivitetet

- Analiza e kontekstit, përcaktimi zonal i shoqatave të të huajve dhe të ndërhyrjeve në dobi të dhëndetit të gruas
- Takime programatike dhe përkrahëse me operatorët e të gjitha Ndërmarrjeve Shëndetësore të Toskanës për promovimin e ofertës aktive të shërbimeve në kontekstin e shëndetit riprodhues dhe të atij nënë-femijë, të njohur si një proces formativ i akredituar në Fushë të Gjerë
- Fuqizimi i formimit të ndërmjetësuesve në kontekstin e shëndetit riprodhues
- Projektimi dhe përpunimi i materialeve multimediale shumë gjuhësore të edukimit me shëndetin (Cd dëgjues i pajisur me librezë informuese dhe video me përkthim)
- Takime tematike me karakter informues për temat që kanë të bëjnë me shëndetin e grave migrante: Të enjtet e “Albero della salute”
- Sensibilizimi i mjeteve massive të shtypit
- Publikime që kanë të bëjnë me metodologjitë dhe strategjitë operative të përdorura për vënien në vijim të aktiviteteve, me rezultatet e arritura dhe instrumentat kryesorë të hartuar e realizuar.